

NË EMËR TË POPULLIT
P.nr.2309/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarene vetme gjykuese Albina Shabani Rama, me procesmbajtësen Ganimete Dumani, në çështjen penale kundër të pandehurit B.I., për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 185 par.2 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2059/16, të dt.19.05.2017, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrit ndëshkimorë PP.II.nr.2059/16 të dt.19.05.2017, më dt.11.04.2018 jashtë seancës, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2059/16 të dt.19.05.2017, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri: B.I., i biri i B. dhe S. e gjinisë G., i lindur me ... në P. , me vendbanim në rrugën “P.V.”, nr. ..., ka të kryer shkollën e mesme, profesioni menaxher, i gjendjes së mirë ekonomike, i martuar, me nr. personal ..., shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e:

Me date 03.04.2016, rreth orës 14:00 në Prishtinë, në rrugën “P.V.” i pandehuri pas një mosmarrëveshje që kishte me të dëmtuarën rrethnjëçështjepronësore të cilën i pandehuri e kishte marrë me qira nga AKP-ja, ku dhe punonte, në afërsi të shtëpisë së të dëmtuarës, e kishte kanosur nëatëmënyre që i kishte thënë se “burrin ta shtina në burg edhe djemtë kom me ti shti në burg e me ty e di çkaboju tani” me ç’rast tek e dëmtuara kishte shkaktuar ndjenjën e frikës dhe pasigurisë.-

-me këtë ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 185 par.2 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 41, 43, 46, të KPRK, si dhe neneve 365 e 495, të KPP të Republikës së Kosovës, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

I pandehuri B.I. dënohet në shumë prej **200 (dyqind) Euro**, të cilin dënim, është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 (njëzet)€ të gjobës.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësorë do të paguaj shumën prej **20.00 (njëzet) €**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Tëdëmtuarën:T.T.-H., me vendbanim në rr. “U.H.” në P.,për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, me Aktakuzën PP.II.nr.2059/16, të dt.19.05.2017,ka akuzuar B.I., për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 185 par.2 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrit ndëshkimorë, me arsyetimin së ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyesh mërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493, të KPP të Republikës së Kosovës, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495, të KPP i RK, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimorë si në dispozitivin të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: Kallëzimi penal i Policisë së Kosovës me nr. 2016-AB-1056i datës 13.04.2016, deklarata e të pandehurit B.I., deklarata e tëdëmtuarit T.T.-H.,dhe foto dokumentacioni me shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lartë, gjykata konstaton se i pandehuri B.I.është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale Kanosja nga neni 185 par.2 të KPRK, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Me rastin e shqyrtimit të dënimit ndaj të pandehurit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 74 të KPK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësorë, është marr në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPP-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPP-së, u vendos si në dispozitivin të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM P.nr.2309/17, dt.11.04.2018

Procesmbajtësja,
Ganimete Dumani

Gjyqtarja,
Albina Shabani Rama

KËSHILLË JURIDIKE:

I pandehuri ose mbrojtësi i tij, në afat prej tetë(8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi-urdhri ndëshkimorë, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.